REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 349, Datë 12.11.2026

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 175, DATË 29.08.2024 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "BMG ENERGY SAL" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3193/3 prot., datë 11.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 175, datë 29.08.2024"Mbi licencimin e shoqërisë "BMG ENERGY SAL" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"*,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "BMG ENERGY SAL" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 175, datë 29.08.2024, vendosi të licencojë shoqërinë "BMG ENERGY SAL" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: "*Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik jo më vonë se data 31.03.2025;* Në pikën 3 i është lënë detyrë shoqërisë *që të depozitojë në ERE, VNM-në Paraprake të re brenda datës 23.10.2024;* ndërsa në pikën 4 është përcaktuar se: *Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE".*

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Nga korrespondenca e zhvilluar me shoqërinë, ka rezultuar se shoqëria ka depozituar VNM-në Paraprake të lëshuar në datën 20.09.2024 dhe me shkresën e saj të fundit të protokolluar në ERE me nr. 141 prot., datë 13.01.2026, ka bërë me dije se nuk ka filluar punimet pasi nuk ishte pajisur me lejet përkatëse për ndërtimin e centralit.
- Me qëllim përditësimin e informacionit lidhur përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 175/2024 si dhe statusin e punimeve për ndërtimin e centralit, u vlerësua e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore. Për këtë qëllim, ERE, me shkresën nr. 3193/1 prot., datë 27.10.2026, njoftoi shoqërinë për zhvillimin e seancës dëgjimore, e cila u mbajt në mjediset e ERE-s më datë 05.11.2026.
- Në seancë shoqëria informoi se është pajisur me VNM Paraprake të re dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3193/2 prot., datë 05.11.2026, shoqëria ka depozituar në ERE VNM-në Paraprake të re të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), datë 06.10.2026.

- Përsa i përket fillimit të punimeve dhe ecurisë së zhvillimit të projektit, shoqëria ka informuar se është pajisur me leje zhvillimi në datën 29.05.2023, se i është miratuar leja e ndërtimit me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU), të datës 30.07.2026 dhe është në pritje të zbardhjes së kësaj leje.
- Po ashtu, në kuadër të ecurisë së projektit dhe hapave të ndërmarrë për zbatimin e tij është depozituar në ERE raportimi periodik pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) (shkresat nr. 11/3 prot., datë 11.03.2024; nr. 06/09 prot., datë 06.09.2024; nr. 12/1 prot., datë 13.01.2026; nr. 15 prot., datë 09.04.2026; nr 19/1 prot., datë 14.07.2026; si dhe nr. 21/1 prot., datë 14.10.2026) dhe AKBN-së (shkresat nr. 12/2 prot., datë 13.01.2026; nr. 16 prot., datë 09.04.2026; nr. 19 prot., datë 14.07.2026; si dhe nr. 21 prot., datë 14.10.2026).
- Në këtë kuadër, sjellim në vëmendje se, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në ERE, më datë 27.05.2025, përfaqësuesi i MIE-s ka propozuar që shoqëritë të depozitojnë në ERE raportimet periodike të paraqitura pranë MIE-s, përmes të cilave dëshmohet aplikimi në afat për pajisjen me lejet përkatëse. Mbi këtë bazë, ERE të vijojë me vendimmarrjen me kusht për fillimin e testimit apo operimit të veprës, duke mundësuar përshtatjen e afateve kontraktore me ecurinë e procedurave pranë institucioneve të tjera publike.
- Në përfundim, duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria është në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit për të filluar punimet, si dhe parashikimin e saj për vendosjen në operim të centralit brenda datës 31.03.2027, shoqëria ka kërkuar ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 175, datë 29.08.2024, duke përcaktuar këtë datë si afatin e ri për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.
- Për gjithë sa më sipër informuar e dokumentuar nga shoqëria, vlerësohet që të vijohet me ndryshimin e pikës 2 dhe përditësimin e datës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, e cila rezulton të jetë brenda afatit të VNM-së Paraprake (e vlefshme deri më 06.10.2028).
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se shoqëria "BMG ENERGY SAL" sh.p.k. ka depozituar pranë ERE-s VNM-në Paraprake të re, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), datë 06.10.2026, e vlefshme deri më datë 06.10.2028. Duke marrë në konsideratë se shoqëria ka propozuar datën 31.03.2027 për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, e cila përfshihet brenda periudhës së vlefshmërisë së këtij dokumenti, vlerësohet se nuk është më e nevojshme mbajtja në fuqi e detyrimit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit nr. 175/2024, për rrjedhojë kjo pikë duhet të shfuqizohet.
- Në të njëjtën kohë, duke marrë në konsideratë ecurinë e procedurave për pajisjen me lejen e ndërtimit, raportimet periodike të shoqërisë pranë MIE-s dhe AKBN-së, si dhe afatin e propozuar prej saj për fillimin e operimit, vlerësohet i arsyeshëm ndryshimi i pikës 2 të vendimit, duke përcaktuar datën 31.03.2027 si afatin e ri për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 175, datë 29.08.2024, si vijon:

a) Pika 2 e vendimit ndryshon dhe bëhet:
   2. *Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, jo më vonë se data 31.03.2027.*
b) Pika 3 e vendimit *shfuqizohet*.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "BMG ENERGY SAL" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI